



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit
P- 082/26
Prishtinë, më 17 shtator 2009
Salla e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 17 SHTATOR 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 81 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqiten këta deputetë:

Kryetari i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Persona të Pagjetur, **Ismet Beqiri**, ngriti shqetësimin lidhur me grevën e nënave të personave të pagjetur, të cilat kërkojnë nga autoritete përgjegjëse identifikimin e 405 mbetjeve mortore.
Ai kërkoi që Kuvendi sot ose në një seancë të veçantë të debatojë lidhur me këtë çështje.

Deputeti **Sabri Hamiti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, propozoi që së bashku me pikat 3, 4 dhe 5, të parapara për shqyrtim në këtë seancë plenare, të shqyrtohet edhe Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Deputeti **Emrush Xhemajli** propozoi që pikat 3, 4, 5 dhe 11 të hiqen nga rendi i ditës dhe të shqyrtohen në një seancë tjetër të radhës.

Deputeti **Adem Salihaj**, në emër të Grupit parlamentar të LDD-së, mbështeti propozimin e deputetit Sabri Hamiti.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, tha se Projektligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit mund të shqyrtohet pasi që MEF ta dërgojë deklaratën për implikimet buxhetore, kurse projektligjet e radhitura në pikat 3, 4 dhe 5 i kanë plotësuar kushtet që të shqyrtohen në seancën e sotme.

Kryeministri **Hashim Thaçi** mbështeti propozimin që pika 3, 4 dhe 5, të parapara për këtë seancë, të shtyhen për ndonjë seancë tjetër të radhës.

Kryetari hodhi në votim propozimin për heqjen e pikave 3, 4 dhe 5 nga rendi i ditës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për84,
Kundër.....4,
Abstenime.....1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin për heqjen e pikave 3, 4 dhe 5 nga rendi i ditës.

Deputetja **Donika Kadaj – Bujupi** propozoi që pika 11 – Debat i për lirinë e medias në Kosovë të hiqet nga rendi i ditës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetes Bujupi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për50,
Kundër.....14,
Abstenime.....1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, hoqi nga rendi i ditës Debatin për lirinë e medias në Kosovë.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 17, 23 dhe 24 korrik 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizmin dhe shërbimet turistike,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për auditimin e brendshëm,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike,

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armët,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 17, 23 dhe 24 korrik 2009

Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtur më 17, 23 dhe 24 korrik 2009, pa vërejtje.

Deputeti **Fatmir Rexhepi** pati vërejtje në Transkript, që është korrigjuar, sipas propozimit të tij.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Riza Smaka parashtoi pyetje për ministrin e Tregtisë dhe të Industrisë, Lutfi Zharku, lidhur me mënyrën e zbatimit të dispozitave të neneve 2, dhe 15 të Ligjit N.r 03/L-129 për zonat ekonomike.

Ministri Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit .

Deputetja Rita Hajzeraj parashtoi pyetje për Kryeministrin, Hashim Thaçi, lidhur me inkurajimin e prodhuesve kosovarë.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Hajzeraj.

Deputeti Dritan Tali parashtoi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me punësimin e punëtorëve me kontratë mbi veprën në PTK.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali .

Deputeti Riza Smaka parashtoi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me gjendjen ekonomike në Kosovë.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka .

Deputetja Gjylnaze Syla i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Alush Gashi, lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore.

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti Riza Smaka i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me interesat bankare në ekonominë vendore.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti Dritan Tali parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me trajnimin tre javorë të punëtorëve të PTK-së në Universitetin e Kentit, në Britani të Madhe.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali .

Deputeti Dritan Tali parashtroi pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me dhënien e bonuseve zyrtarëve në ndërmarrjet publike.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupaj parashtroi pyetje për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, lidhur me shkatërrimin e pyjeve në Kosovë.

Ministri Vehapi iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadaj-Bujupi.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizmin dhe shërbimet turistike

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për turizmin dhe shërbimet turistike.

Ministri **Lutfi Zharku** arsyetoi nevojën për nxjerrjen e këtij projektligji, objektivat që do t'i realizojë ky projektligj; mënyrën e realizimit të objektivave, si dhe ndikimet financiare për zbatimin e projektligjit.

Në vazhdim, ministri shpjegoi strukturën e projektligjit, me të cilin rregullohet fusha e turizmit dhe e shërbimeve turistike.

Në fund, ministri Zharku kërkoi nga deputetët që ta miratojnë, në parim, Projektligjin për turizmin dhe shërbimet turistike.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtim, në parim, të Projektligjit për turizmin dhe shërbimet turistike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadergjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatmir Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputeti: **Riza Smaka** dhe Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, **Lutfi Zharku**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij Projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për turizmin dhe shërbimet turistike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues; Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe Komisionin për Integritet Evropian që projektligjin ta shqyrtojnë brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për auditim të brendshëm

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja **Safete Hadergjonaj** tha se komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe në fund ka hartuar disa amendamente, me të cilat përmirësohet struktura e këtij projektligji. Ajo kërkoi nga deputetët që t'i miratojnë amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim një nga një amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për auditimin e brendshëm.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Askush nuk u paraqit nga komisioni funksional.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, dhe 6.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,

Kundër-----0,
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për rendin dhe qetësinë publike.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armët

Kryesuesi ftoi Kryetarin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri ose raportuesin e komisionit, që ta marrë fjalën.

Askush nuk u paraqit nga komisioni funksional.

Kryesuesi i hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20.

Kryesuesi hodhi në votim Projektligjin në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër-----13,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për armët.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit

Kryesuesi i informoi deputetët me Rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion për Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit.

Ai ftoi përfaqësuesin e Komisionit që ta arsyetojë raportin.

Kryetarja i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, **Myzejene Selmani**, tha se Komisioni ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit konkludoi se kandidatët e propozuar për anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit: Ekrem Hoxha-Kryesues, Lulzim Kurtaj, Besnik Berisha, Naser Shala dhe Njazi Ademaj i plotësojnë kushtet e parapara me ligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë dhanë këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser**

Rugova, si dhe deputeti: **Edita Tahiri, Driton Tali, Numan Baliq, Lulzim Zeneli, Zef Morina, Gani Biqinca, Riza Smaka, Sala Berisha, Bahri Hyseni, Fatmir Rexhepi, Ramadan Avdiu, Hajdin Abazi, Gani Geci** dhe **Armend Zemaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, kryesuesi hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për32,
Kundër.....28,
Abstenime..... 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit

I. Anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit emërohen:

1. Ekrem Hoxha- kryesues,
2. Lulëzim Kurtaj- anëtar,
3. Besnik Berisha- anëtar,
4. Naser Shala- anëtar,
5. Njazi Ademaj- anëtar.

II. Mandati i anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit zgjat pesë (5) vjet.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 14:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**